



Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2013 - 31 Dhjetor 2013

Përmbajtja:

Raporti i Auditorëve të Pavarur.....	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	8
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	9
Shënimet e pasqyrave financiare.....	10-13

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i kualifikuar

Ne kemi audituar Raportet financiare të bashkëngjitur të Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “AAK”), të përbëra nga pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2013, pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira në fq. 6-13.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, pasqyrat financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 31 Dhjetor 2013, dhe të hyrat dhe shpenzimet për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058

Baza për opinionin të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Siç paraqitet në shënimin 5 të pasqyrave financiare, detyrimet tjera afatshkurtra janë te prezantuar në vlerë 71,565.69 euro me 31 Dhjetor 2013. Në mungesë të konfirmimeve nga palët e treta, ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit të përfitojmë një siguri të arsyeshme në lidhje me tërësinë, ekzistencën dhe saktësinë e vlerës 35,423.00 Euro 31 dhjetor 2013.
- SP gjatë vitit 2013 ka operuar me një (1) llogari kryesor bankare dhe me 27 nënlllogari në kuadër të Raiffesisen Bankës në kundërshtim me kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-

058 neni 3 pika 3, c cili lejon subjektet politike te kenë një llogari te vetme bankare.

- Gjatë auditimit ton është konstatuar se në kuadër të beneficioneve të tjera Subjekti Politik ka bërë kompensime mujore personit jo rezident të Kosovës për shërbime në shumën totale prej 28,800.00 euro për të cilin nuk i është ndaluar tatimi në burim sipas Legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës.
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar se nga totali i shpenzimeve te deklaruar ne vlerë 631,813.31 euro për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2013, 73,050 euro janë mjete të transferuara-bartur kesh degëve të saja mirëpo pa u mbështetur me dokumentacion mbështetës mbi ndodhjen e shpenzimeve.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti politik nuk ka shpalosur shënimet mbi pagesat e kryera në vlerë mbi 5,000.00 Euro një marrësi te vetëm brenda ditës ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.
- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave

financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të SP.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në

përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Fadil Hyseni
Auditor Ligjor
5 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	9,903.00	8,245.14
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		9,903.00	8,245.14
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet		1,439.22	4,285.15
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	321.29	8,489.38
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		1,760.51	12,774.53
Total pasuritë		11,663.51	21,019.67
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		12,774.53	4,285.15
Suficiti / (deficiti) i vitit		(114,611.17)	8,489.38
Total Ekuiteti		(101,836.64)	12,774.53
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera	2	9,903.00	8,245.14
Gjithsej detyrimet agatgjata		9,903.00	8,245.14
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	4	32,031.46	0.00
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	5	71,565.69	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		103,597.15	0.00
Gjithsej detyrimet		113,500.15	8,245.14
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		11,663.51	21,019.67

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2013	2012
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		394,433.00	395,899.00
Të hyrat nga anëtarësia			
Donacionet dhe kontributet në të holla		0.00	2,000.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime			
Të hyrat e fushatës		119,410.00	
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		3,359.14	
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		517,202.14	397,899.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompenzimet	6	300,834.00	273,806.97
Shpenzimet e transportit	6	26,438.43	14,991.35
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	6	113,741.87	48,194.05
Shpenzimet e fushatës	6	99,640.00	
Blerja e mallrave	6	11,375.81	7,125.80
Shpenzimet e përgjithshme	6	58,319.26	15,437.82
Shpenzimet e ndryshme	6	21,463.94	29,853.63
Gjithsej shpenzimet për vitin		631,813.31	389,409.62
Suficiti / (deficiti) për vitin		(114,611.17)	8,489.38

1. Informata te përgjithshme

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është partia e tretë më e madhe në Kosovë. Është një parti konservatore dhe liberale konservatore

Udhëheqja: Ramush Haradinaj (Kryetar i partisë)

Themelues: Ramush Haradinaj

Themeluar: në vitin 2000

Pasqyrat financiare te Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 „Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën RBKO.

Subjekti Politik i ka 36 degë në territorin e Republikës së Kosovë.

Subjekti Politik nuk ka database mbi numrin e antarëve të saj.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////		0.00
Objektet					0.00
Veturat					0.00
Pajisjet e zyrës	5,191.10	785.00	1,557.30	1,195.22	3,223.58
Pajisjet e teknologjisë informative	4,715.56	4,232.00	1,414.66	1,789.51	5,743.39
Pajisjet tjera	1,872.05		561.61	374.41	936.03
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	11,778.71	5,017.00	3,533.57	3,359.14	9,903.00

Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Paraja në bankë	21.33	8,489.38
Paraja në arkë	299.96	
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	321.29	8,489.38

Shënimi 4. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Te pagueshme ndaj mediave	32,031.46	
Llogari të pagueshme të tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme dhe të tjera	32,031.46	0.00

Shënimi 5. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime	71,565.69	
Detyrimet tjera afatshkurtra		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	71,565.69	0.00

Shënimi 6: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto	259,094.62	187,528.93	71,565.69
Kontributet pensionale të punëmarrësit			-
Kontributet pensionale të punëdhënësit	12,939.38	12,939.38	-
Tatimet në të ardhura personale			-
Beneficionet tjera	28,800.00	28,800.00	-
Gjithsej	300,834.00	229,268.31	71,565.69
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	1,385.00	1,385.00	-
Karburantet	3,180.03	3,180.03	-
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	11,447.19	10,257.19	1,190.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave	10,426.21	6,606.23	3,819.98
Çdo shpenzim tjetër i transportit	0.00	0.00	-
Gjithsej shpenzimet e transportit	26,438.43	21,428.45	5,009.98
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	16,597.00	4,509.00	12,088.00
Ushqimi	8,051.86	8,051.86	-
Aktivitete kulturore dhe rekreative	150.00	150.00	-
Radio dhe spotet televizive	61,500.00	61,500.00	-
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	8,726.13	8,726.13	-
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	18,716.88	18,716.88	-
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	113,741.87	101,653.87	12,088.00
Shpenzimet e fushatës			

Shpenzimet e fushatës	99,640.00	99,640.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	99,640.00	99,640.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	8,276.40	8,274.40	2.00
Pajisjet të vogla	3,099.41	2,345.61	753.80
Gjithsej blerja e mallrave	11,375.81	10,620.01	755.80
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	44,389.60	30,439.60	13,950.00
Telefoni, interneti dhe posta	2,482.31	2,482.31	-
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	8,088.21	3,000.00	5,088.21
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	3,359.14	-	-
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet në natyrë në mallra dhe shërbime			-
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	58,319.26	35,921.91	19,038.21
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	21,463.94	13,549.94	7,914.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	21,463.94	13,549.94	7,914.00
Gjithsej shpenzimet	631,813.31	512,082.49	116,371.68